



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2058 prot.

Tiranë, më 27.06.2018

### INFORMACION

#### MBI MANDATET E KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë depozituar kërkesa nga disa kryetarë të gjykatave të cilët për shkak se i'u ka mbaruar apo janë në prag të mbarimit të mandatit për ushtrimin e funksionit drejtues në gjykatë, shprehin dëshirën për të vijuar të jenë përsëri kryetar të gjykatës.

Aktualisht në ushtrim të detyrës së kryetarit janë **37** kryetarë gjykatë të cilët janë të emëruar me vendim të KLD-së, ndërkohë që aktualisht **4** kryetarë gjykatë janë të komanduar për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës.

Kuadri ligjor i emërimit të kryetarëve të gjykatave aktual, ka qenë referuar në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si në Vendimin nr.227/2, datë 28.03.2008, "Për funksionin drejtues në gjykata", të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mandati i të cilëve në ushtrim të kësaj detyre ka qenë 4-vjeçar (neni 17 i ligjit nr. 9877/2008 "1. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit qëndrojnë në detyrë për katër vjet, me të drejtë riemërimi, sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji.").

Aktualisht u ka mbaruar mandati për 11 kryetarëve gjykatë dhe konkretisht:

1. Gjyqtar Artan Çupi – kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat (datë 11.10.2013);
2. Gjyqtar Kastriot Selita – kryetar, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë (datë 28.10.2013);
3. Gjyqtar Fuat Vjerdha – kryetar, Gjykata e Apelit Shkodër (datë 17.01.2014)
4. Gjyqtare Entela Prifti – kryetare Gjykata e Apelit Korçë (datë 17.01.2014);
5. Gjyqtar Dritan Banushi – kryetar Gjykata e Apelit Gjirokastrë (datë 17.01.2014);
6. Gjyqtare Alma Liçaj– kryetare, Gjykata e Apelit Vlorë (datë 17.01.2014).
7. Gjyqtar Petrit Çeno – kryetar, Gjykata e Apelit Durrës (datë 11.04.2014);
8. Gjyqtar Halil Vani – kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër (datë 11.04.2014);
9. Gjyqtar Isuf Shehu – kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës (datë 28.05.2014);
10. Gjyqtar Alltun Çela – kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (datë 28.05.2014);

11. Gjyqtar Sandër Simoni – kryetar, Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda (datë 28.05.2014);

Ndërkohë në 6 mujorin e II-të të këtij viti ju mbaron mandati edhe 11 kryetarëve të gjykatave dhe konkretisht:

1. Agron Vavla – kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat (datë 30.06.2014)
2. Eriol Roshi -kryetar, Gjykata Administrative Tiranë (data 07.07.2014)
3. Alma Kolgjoka - kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë (data 11.07.2014)
4. Esmeralda Çeka - kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje (data 23.07.2014)
5. Admir Belishta- kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (data 23.07.2014)
6. Entela Shedula -kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë (data 11.07.2014)
7. Roland Jaupaj- kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (data 23.07.2014)
8. Joana Qeleshi-kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (data 17.10.2014)
9. Alfred Gjoni -kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin (data 17.10.2014)
10. Arben Zefi -kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (data 17.10.2014)
11. Skënder Haluci -kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (data 17.10.2014)

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit në RSH”, në nenin 52 “**Emërimi i kryetarëve të tjerë**” parashikon se mandati i kryetarit të gjykatës është 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Gjithashtu në pikën 2 të të njëjtës dispozitë parashikohet kryetari në detyrë i gjykatës jo më vonë se 6 muaj nga mbarimi i mandatit, duhet të kandidojë për kryetar, nëse nuk kandidon i konsiderohet se ka dhënë dorëheqje si kryetar në fund të mandatit.

“1. Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Mandati i kryetarit të Prokurorisë së Posaçme është tre vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë metë drejtënerizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat tjetër. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit. 3. ...”

Aktualisht nga kryetarët të cilët ushtrojnë detyrën dhe që kanë paraqitur kërkesë janë si më poshtë:

1. Gjyqtar Fuat Vjerdha – kryetar gjykatës së Apelit Shkodër, kërkesë formale e datës 07.07.2017, regjistruar me aktin tonë nr. 2237 prot., datë 10.07.2017;
2. Gjyqtar Dritan Banushi – kryetar gjykatës së Apelit Gjirokastrë, kërkesë formale e datës 17.07.2017, regjistruar me aktin tonë nr. 2319 prot., datë 20.07.2017;
3. Gjyqtar Kastriot Selita - kryetar gjykatës së Administrative të Apelit, kërkesë formale e datës 21.07.2017, regjistruar me aktin tonë nr. 2328 prot., datë 21.07.2017.
4. Gjyqtar Agron Vavla – kryetar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, kërkesë formale e

datës 25.06.2018, regjistruar me aktin tonë nr.2041 prot., datë 25.06.2018.

Sa i përket këtyre kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi emërimin e kryetarëve të gjykatave, bazuar në nenin 160 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se në periudhën tranzitore në të cilën ndodhet aktualisht Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ky këshill nuk mund të bëjë emërimë për caktimin në funksionit të kryetarit në këto gjykata.

Kjo situatë, për sa i përket kryetarëve të gjykatave të krimeve të rënda vlerësohet e rregulluar, për shkak se në nenin 162, pika 6, parashikohet se kryetarët e këtyre gjykatave vazhdojnë të qëndrojnë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të gjykatës së posaçme, me kushtin që të mos ketë shkak për mbarimin e statusit të magjistratit si pasojë e rivlerësimit të kalimtar të tyre (vetting-u). Konkretisht: “6. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të gjykatës së posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ndërkohë, për kryetarët e gjykatave të tjera, në nenin 164, pika 2, të ligjit për Statusin, fillimisht ishte parashikuar që vijimi i ushtrimit të detyrës së kryetarëve të gjykatave do të jetë deri në 9 muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

“2. Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë sikryetar deri 9 muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”.

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, këtë dispozitë të sipërcituar, me vendimin nr. 34 datë 10.04.2017, e ka konstatuar dhe e ka shfuqizuar si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës, konkretisht, pikën 2 të nenit 164, pra ka shfuqizuar vazhdimësinë në detyrë si kryetar deri në 9 muaj pas ngritjes së KLGJ. Shfuqizimi i kësaj pike ka qenë një prej kërkesave të bëra para kësaj Gjykate, nga dy shoqatat e gjyqtarëve, si një dispozitë që “... ndërpresin me fuqi prapaveprues mandatin kushtetues të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe mandatin e kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, cenon krahas së drejtës së karrierës, edhe të drejtën për pagë.”.

Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata pasi ka marrë në konsideratë se parimet themelore të shtetit të së drejtës të cilat nënkuptojnë, midis të tjerave, edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuar për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe sigurisë juridike, për shkak të fuqisë prapavepruese të neneve të analizuar, është i bazuar (pika 67, e vendimit nr. 34/2017.)

Gjithsesi Gjykata, në këtë vendim, konkretisht në pikën 30 por dhe në pikën 61, “...shpreh se fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës. Kjo vlerë kushtetuese garantohet veçanërisht nga neni 179/a i Kushtetutës, i cili parashikon shprehimisht se mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të

emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë përjashtuar nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 (kur verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik) dhe 45, pika 3 (si rregull ata që janë dënuar me burgim me vendim përfundimtar të formës së prerë për kryerjen e një krimi, ose të tjerë sipas rasteve përjashtimore dhe të justifikuar) të Kushtetutës. Përveç sa më sipër, Kushtetuta përmban një rregullim të veçantë në nenin 179, pika 10 për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përcaktuar se ata që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, qëndrojnë në detyrë dhe i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës.”

Ndaj sa më sipër vlerësojmë që çështja të diskutohet në mbledhje plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me qëllim informimin e anëtarëve me këtë situatë, si dhe për të vlerësuar dhe për të mbajtur qëndrimin nëse kryetarët e gjykatave të tjera, përveç atyre të gjykatave të krimeve të rënda, të vijojnë ushtrimin e detyrës deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sekretari i Përgjithshëm: Pjerin Prendi

Drejtorja e Administratës dhe Financës: Xhevdet Haxhiu

Drejtorja Juridike: vildan Kaloshi

